



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 385, datë 13.12.2021

**PËR MIRATIMIN E SHKALLËS SË VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE
PËR NGRITJEN NË DETYRË PRANË PROKURORISË SË POSAÇME**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës, në nenin 47 pika 1 germa "b" dhe 48 pika 1 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2 dhe 189 pika 1 germa "a" të Ligjit nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar si dhe të nenit 16 të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar", e ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë shkallën e vlerësimit për secilin kriter dhe për secilin kandidat për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, si më poshtë:

Nr	Emri e mbiemri i kandidatit	KOMPONENTËT E VLERËSIMIT TË AFTËSIVE SIPAS SHKALLËVE	
		Ndjekja penale, Hetimi, Teknikat, Përfaqësimi, konfiskimi	Vendosmëria dhe Integriteti
1	Alfred Shehu	Vlerësim i lartë	Vlerësim i lartë
2	Elvin Gokaj	Vlerësim i lartë	Vlerësim i lartë
3	Sonila Muhametaj (Domi)	Vlerësim i lartë	Vlerësim i lartë

Vlerësimi i Performancës				
Nr.	Emri e mbiemri i kandidatit	Viti Paraardhës	Viti i Fundit	TOTALI
1	Alfred Shehu	Shumë mirë 2.5 pikë	Shumë mirë 2.5 pikë	5 pikë
2	Elvin Gokaj	Shumë mirë 2.5 pikë	Shumë mirë 2.5 pikë	5 pikë
3	Sonila Muhametaj (Domi)	Shumë mirë 2.5 pikë	Shumë mirë 2.5 pikë	5 pikë

2. Raporti përmbledhës mbi veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme dhe rezultatet e vlerësimit, është pjesë përbërëse e këtij vendimit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR
MOISI DUDA**

**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**